

Tregim Suksesi

Fuqizimi i barazisë ekonomike për të gjitha gratë



Foto: Dyqani artizanal në Drenas

Fuqizimi ekonomik i gruas është një parakusht për zhvillim të qëndrueshëm dhe rritje tek të varfrit. Fuqizimi i grave e rrit qasjen në burimet dhe mundësitë ekonomike, duke i përfshirë vendet e punës, shërbimet financiare, pronën dhe pasuritë tjera prodhuese, zhvillimin e aftësive dhe informimin e tregut. Gratë në Kosovë mbeten në situatë shumë të vështirë socio-ekonomike dhe e theksojnë nevojën për qasje në inpute produktive, trajnime dhe punësim.

Realiteti sot tregon se ka nevojë për më shumë mbështetje në lidhje me pavarësinë ekonomike dhe financiare për gratë e dhunës në bazë gjinore dhe seksuale (SGBV) dhe pakicave të marginalizuara, për arsimim më të mirë dhe mbështetje për vetëpunësim në të gjitha nivelet. Duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm që luajnë gratë në familje dhe rolin e tyre të papranuar në komunitet, nevoja për ndërhyrje më të orientuara nga komuniteti mbetet prioritet për shoqërinë tonë.

Përfituesi i programit Angazhimi për Barazi, Qendra e Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) në partneritet me Qendrën për Promovimin e Familjes së Shëndetshme (QPFSH) dhe Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave (QPDG), po e zbaton projektin “Fuqizimi i barabartë ekonomik për të gjitha gratë në Kosovë”. Si rezultat i punës së zellshme dhe bashkëpunimit të mirë midis tri organizatave, hapja e dyqanit artizanal u promovua në objektin e Qendrës për Promovimin e të Drejtave të Grave në Drenas. Dyqani synon rritjen e nivelit të punësimit për gratë/të mbijetuarat e dhunës seksuale dhe gjinore në Kosovë për të krijuar mundësi të barabarta, integrim social dhe mirëqenie të gruas. Hapja e këtij dyqani do ta mundësojë vetëpunësimin e 25 grave dhe do të gjenerojë të ardhura, të dedikuara për këtë grup të grave që punojnë aty. Të gjitha produktet janë punë dore, kryesisht veshje tradicionale, çanta dhe suvenire, të cilat gjithashtu mund të blihen përmes internetit në këtë faqe: <http://qpdg.org/>. Përveç dyqanit që fuqizon gratë për mundësi të barabarta ekonomike, projekti i QKRMT-së fokusohet në arsimin profesional, avokimin dhe rrjetëzimin për mundësi punësimi për gratë.

QKRMT-ja e zbaton projektin “Fuqizimi i barabartë ekonomik për të gjitha femrat në Kosovë”, përmes programit Angazhimi për Barazi, i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe realizohet nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC).